

MINISTRIA E ENERGJISË DHE MINIERAVE



MINISTRIA E ENERGJISË DHE MINIERAVE
MINISTARTSVO ENERGIJE I RUDARSTVA
MINISTRY OF ENERGY AND MINING

Minutat e takimit të 10-të

Grupi Punues për Energji

17 janar 2008

MINISTRIA E ENERGJISË DHE MINIERAVE

Minutat e Takimit të Dhjetë të Grupit Punues për Energji

Hyrje:

Takimi i dhjetë i rregullt i grupit punues për energji (GPE) është mbajtur me datë 17, janar 2008 prej orës 14:00 ne Sallën e takimeve në Ministrinë e Energjisë dhe Minierave, dhe është udhëhequr nga Drejtori i Departamentit për Strategji dhe Zhvillim z. Gëzim Pula.

Pikat e rendit të ditës

1. Progresi i aktiviteteve në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë – Prezantuar nga Gëzim Pula, Drejtor i Departamentit për Strategji dhe Zhvillim
2. Plani Kosovar i Veprimit për Partneritetin Evropian 2008 – Hapat të cilat duhet të ndërmerren për hartimin e PVPE-së 2008 – Prezantuar nga Agim Zuzaku, Koordinator i Njësisë për Integritime Evropiane.
3. Instruksionet për plotësimin e matricës së prioriteteve – Prezantuar nga Demush Shasha, Agjencia për Integritime Evropiane.

Prezantimet në vijim

Gëzim Pula-MEM: Shkurtimisht informoi për zhvillimet e fundit në Traktatin e Komunitetit të Energjisë (TKE), temat kryesore të cilat u prezantuan ishin:

1. Progresi gjatë muajit nëntor 2007 – janar 2008
2. Takimi i 7-të i PHLG (Permanent High Level Group) në Vjenë
3. Zbatimi i planeve të detajuara të veprimit për energji elektrike dhe gaz
4. Aktivitetet vijuese në kuadër të TKE-së për gjysmën e parë të 2008

Për më tepër prezantimi.

Agim Zuzaku-MEM: Prezantoi një material për hapat të cilat duhet të ndërmerren për plotësimin e matricave të prioriteteve. Gjithashtu i njoftoi të pranishmit që sot ky takim është më tepër informues, ku do të jepen detyra çdo akteri që bënë pjesë në GPE që pastaj të vazhdojnë punën nëpër institucionet e tyre dhe pastaj të dërgohen në MEM.

Për më tepër prezantimi.

Demush Shasha: Së pari tregoi rëndësinë e PVPE-së dhe tregoi që shumë shpejt edhe Kryeministri i Kosovës do tu dërgoi një letër të gjithë Ministrave, ku do ta mbështetë

fuqishëm proceset e integritit evropian. Gjithashtu, demonstroi përmes kompjuterit se si duket matrica dhe adresari i plotësuar më herët nga MEM. Pas demonstrimit i njoftoi të pranishmit që afati i fundit për dorëzimin e draftit të parë të plotësimit të matricave apo drafti i PVPE-së për vitin 2008 është 25 janar, 2008.

Diskutime

Diskutimet filluan pas përfundimit të z. Shasha, ku u parashtruan disa pyetje dhe komente.

Vaso Leno: Shtroi një pyetje se në tabelë është edhe një kolonë për buxhetin. Dihet se planifikimi i buxhetit për vitin 2008 është kryer, si do të arrini ti futni në planifikim edhe shpenzimet e veprimeve që do të dalin për nga PVPE?

Z. Leno gjithashtu kërkoi nga AIE që ti ndihmoj MEM-it me një zyrtar i cili e përcjellë energjinë, e që ky zyrtarë gjatë kësaj kohe sa është duke u hartuar PVPE të qëndroj në MEM për shkak të koordinimit të punëve më mirë. Këtë mendim e mbështeti z. Pula.

Gëzim Pula: Pyeti se kush i ka përcaktuar këto prioritete? Gjithashtu ngriti shqetësimin për përcaktimin e personave përgjegjës për prioritete dhe shpjegoi se AIE duhet ta njohë më mirë funksionimin e sistemit në Kosovë, përkatësisht të Ministrive dhe të ndërmarrjeve publike në këtë rast me KEK-un.

Sa i përket adresarit dhe përcaktimit të përgjegjësve për prioritete është punë interne dhe do ta shqyrtojmë edhe njëherë së bashku me Sekretarin këtë çështje.

Nysret Avdiu: kërkoi nga AIE që nëse është e mundur ti dërgohen prioritetet në gjuhën angleze për shkak se ju është humbur kuptimi i fjalëve kur janë përkthyer në gjuhën shqipe. Edhe për këtë u pajtuan AIE.

Salvador Elmazi: ngriti një çështje ku mori si shembull prioritetin 81 i cili është “Të vazhdohet zbatimi i përpjekjeve të ndërmarra në kornizën e Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Të vazhdohet përgatitja e projektit “Kosova C” për gjenerim të elektricitetit dhe furnizim në përputhshmëri të plotë me *acquis* ashtu siç paraqiten në Traktatin e Komunitetit të Energjisë” dhe pikërisht për Kosovën C ku bëri pyetje se çfarë kompetence ka z. Pula që është përgjegjës për këtë prioritet, që të ndikoi te z. Lorik Haxhiu për ndonjë çështje që ka të bëjë me të, kur dihet se Zyra e Projektit i raporton direkt Komitetit Drejtues të Projektit. Tani marrim shembull rastin e prioritetit 80 “Të sigurohet qëndrueshmëria e shërbimit të energjisë elektrike, duke rritur substancialisht mbledhjen e të ardhurave dhe duke promovuar qeverisjen e mirë” ku jam i caktuar si përgjegjës, çfarë kompetenca kam unë të ndikoj në rritjen e të ardhurave apo diçka tjetër. Unë mundem ti dërgoj vetëm një e-mail sa për tu arsyetuar, mirëpo sa është funksionale ajo kur dihet se nuk kam kompetencat e duhura që të ndikoj për përmbushjen e këtij prioriteti, kur dihet se KEK ka bordin e vet të drejtorëve të cilit edhe i përgjigjet.

Në fund u morr vendim që të gjithë akterët të punojnë në identifikimin e veprimeve dhe të takohen në fillim të javës së ardhshme me grupe më të vogla ku do të shqyrtohen dokumentet e punuara dhe të plotësohen nëse është nevoja.

Lista e Pjesëmarrësve:

Lista e pjesëmarrësve në takim e mbajtur në MEM për PVPE Datë: 17.01.2008				
Nr.	Emri	Mbiemri	Pozita	Institucioni
1	Dukagjin	Shala	Shef i divizionit të gjeologjisë	MEM
2	Labinot	Gashi	Special. në sek. për ç.r	KOSTT
3	Resmije	Ahmeti	Drejt. e departamentit	KOSTT
4	Muharrem	Gashi	Ekonomist	ZRRE
5	Rifat	Blakaj	Udh. depar. FEST	ZRRE
6	Nusret	Avdiu	Anëtar bordi	ZRRE
7	Afrim	Ajvazi	U.d. kryesus i DLL	ZRRE
8	Alma	Tafarshiku	Konsulente	WYG/DFID
9	Demush	Shasha	Zyrtar i lartë	AIE/ ZKM
10	Bedri	Dragusha	Këshilltar i Ministrit	MEM
11	Gëzim	Pula	Drejt. e departamentit të strategjisë	MEM
12	Driton	Rrustemaj	Drejtor për tarifa	ZRRE
13	Bruce	Hutchinson	Këshilltar	KEK
14	Ali	Hoxha	Menaxher për tarifa	KEK
15	Sherif	Avdyli	Menaxhere për mbështetje teknike dhe analiza	KEK
16	Nazmi	Gashi	Menaxhere për licenca	KEK
17	Salvador	Elmazi	Drejtor i departamentit të energjisë	MEM
18	Dardan	Sadriu	Zyrtar	AIE
19	Vaso	Leno	Këshilltar	MEM
20	Agim	Thaqi	Udhëhq. I zyrës së financave	MEM
21	Agim	Zuzaku	Koordinator për Integritet Evropiane	MEM
22	Luan	Morina	Zyrtar i lartë	MEM

Minutat e takimit u përgatiten nga z. Agim Zuzaku

Agjenda

Takimi i Dhjetë i Grupit Punues për Energji

Data: 17.1.2008, Dite e Enjte		
Kohëzgjatja e parashikuar: 14:00 – 16:00		
Lokacioni: Ministria e Energjisë dhe Minierave – Salla e takimeve kati II		
<u>Koha</u>	<u>Tema</u>	<u>Prezantues</u>
14:00 - 14:30	Hyrje	
	<ul style="list-style-type: none">- Pershendetje- Progresi i aktiviteteve ne kuader te Traktatit per Komunitetin e Energjise- Aktivitetet per te ardhmen	Gezim Pula, MEM
14:30 - 15:00	Mbi pergatitjen e Planit te Veprimeve per Partneritet Evropian per vitin 2008	Agim Zuzaku, MEM
15:00 - 15:10	Informacion i shkurter nga AIE	Perfaqesuesi i AIE
15:10-15:50	Diskutime	
15:50 - 16:00	Agjenda per takimin e ardhshem	